



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:256848

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06381744

AC-I-24-0580

Në ankesën e

Paditësi

E Zh, nga Podujeva, i përfaqësuar përmes avokatit B I, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH, FAN "Zahir Pajaziti" Podujevë (në likuidim), të cilën e përfaqëson,
Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë,
Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6094 të datës 18 korrik 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6094 të datës 18 korrik 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 10 shtator 2014, paditësi përmes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0211 i datës 25 gusht 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën e pa përcaktuar. Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se paditësi ka punuar për NSH FAN "Zahir Pajaziti", në Podujevë, nga 17 korrik 1984 e deri me 24 mars 2006, mirëpo ligji relevant i kohës që ishte i zbatueshëm gjatë aktivitetit të ish AKM-së, nuk ka dhënë shprehimisht të drejtë punëtorëve të kërkojnë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e cila e drejtë më vonë njihet me Ligjin nr. 03/L-067 për AKP-në, dhe atë që nga qershori i vitit 2008. Tutje Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se paditësi kërkesën e tij nuk e ka parashtruar në afatin e duhur ligjor në ndonjë Gjykatë apo Autoritet kompetent. Në ankesë paditësi ka pohuar se në NSH ka punuar deri me 24 mars 2006, kur kjo ndërmarrje është privatizuar. Ai pohon se e ka pranuar Njoftimin nga ana e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, dhe duke u bazuar në këtë njoftim, pastaj ai pas fillimit të procedurave të likuidimit ka paraqit kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit lidhur me kompensimin e tij për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Në ankesë ai pretendon se i ka më shumë se 18 vite përvojë pune në ndërmarrje, andaj ka të drejtë në 3 paga në kompensim në shumë prej 2,017.62 euro si dhe interesin ligjor, prej 10%. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur Kopjen e autorizimit për përfaqësuesin, kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopjen e Librezës së punës dhe një kopje të Listës për 20%.

Me datë 08 mars 2024, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka sjellë dëshmi për të vërtetuar se ai këto paga i ka kërkuar më herët në ndonjë gjykatë kompetente, andaj kërkesat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se ankuesi nuk ka paraqitur në ankesën e tij i cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar. AKP-ja pohon se njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së

punës nuk mundet të konsiderohet asnjëherë si pranim i borxhit, duke pohuar se kjo letër ka të bëjë me realizimin e të drejtës nga lista për 20%. Në mbrojtjen në ankesë ajo ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 27 maj 2024, shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshoi një Urdhër për paditësin me të cilën kërkoi të dorëzoi prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 03 korrik 2024, si përgjigje ndaj Urdhrit të shkallës së I-rë, paditësi e dorëzon edhe një parashtrësë në DHPGJS, dhe bashkë me parashtrësë dorëzon Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe një Listë të pagave për tre muajt para privatizimit të NSH-së, dhe kopjen e Librezës së punës.

Me datë 18 korrik 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14- 6094, e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe e obligon AKP-në që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ti paguaj paditësit shumën prej 1,442.28 euro, interesin ligjor prej 10% të shumës themelore, ose në shumë prej 144.22 euro, shpenzimet e procedurës prej 124 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi ishte një punëtor i NSH Fan "Zahir Pajaziti" në Podujevë i cili ka pretenduar se ka qenë punëtor i saj deri në momentin e privatizimit me 24 mars 2006. Tutje Shkalla e I-rë ka konstatuar se me njoftimin e AKM-së të datës 24 mars 2006, dërguar paditësit ai është udhëzuar që çdo kërkesë kreditore që mund ta ketë ndaj NSH-së ta paraqet në procedurën e likuidimit, kur do të fillojnë këto procedura. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se e paditësi në bazë të përvojës së punës që kishte në NSH i takojnë 4 paga mujore prej 360.57 euro, ose në shumë të përgjithshme prej 1,442.28 euro, bazuar në përvojën e tij të punës që vërtetohet në bazë të Librezës së punës. Shkalla e I-rë konstaton se kërkesa nuk është parashkruar, siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit, pasi që Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës. Në arsyetim shkalla e I-rë e DHPGJS-së i referohet edhe disa rasteve të mbyllura në jurisprudencën e Kolegjit të Apelit.

Me datë 31 korrik 2024, e paditura (në tekstin e mëtejme ankuesja) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-6094 të datës 18 korrik 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit e paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar- afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja pretendon se kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është dashtë të paraqitet menjëherë pas qershorit 2008, e afati është 3 vite deri në qershor 2011, ndërsa kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me 27 shtator 2013, që nënkupton se kërkesa është parashkruar.

Me datë 26 gusht 2024, paditësi e dorëzoj në DHPGJS një parashtesë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtesë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar duke konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje paditësi pohon se AKP-ja i ka pasur të gjitha të dhënat dhe dokumentet e ndërmarrjes dhe e ka ditur për borxhet e ndërmarrjes, mirëpo pa të drejtë i ka refuzuar kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Në këtë parashtesë paditësi kërkon që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 27 shtator 2013, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe i ka kërkuar që ai të kompensohet për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e cila kërkesë nuk është specifikuar. Me ankesë paditësi e specifikon shumën prej 2,017.62, dhe kërkon interesin ligjor.

Kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se në kohën e Ligjit të zbatueshëm të veprimit të AKM-së, nuk është përcaktuar kjo kërkesë që mund ti njihet parashtruesit edhe pse ai në bazë të arkivës së ndërmarrjes shihet se ishte në punë në NSH Fan "Zahir Pajaziti", në Podujevë deri në 24 mars 2006. Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se kjo kërkesë mund ti njihet parashtruesit vetëm pas qershorit 2008, kur është aprovuar Ligji i AKP-së, gjë që në këtë rast paditësi nuk e ka përfill afatin ligjor duke mos dorëzuar kërkesën brenda 3 viteve, andaj kjo kërkesë është parashkruar në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së nuk e ka pranuar qëndrimin ligjor të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi ka sjellë prova të mjaftuara që vërtetojnë se ai ishte punëtor i NSH-së deri në privatizimin e saj me 24 mars 2006, si dhe prova për lartësinë e kërkuar të kompensimit, andaj duke u bazuar në këto prova atij duhet ti njihet pjesërisht e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,442.28 euro pasi që i njëjti ka plotësuar kushtet nga neni 40.1.6.2 të

Shtojcës të Ligjit të AKP-së dhe nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, lidhur me përvojën e punës.

Kolegji i Apelit vëren se shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë pjesërisht e kishte aprovuar ankesën dhe e kishte ndryshuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit duke ja njohur paditësit kërkesën për kompensim në shumë prej 1,442.28 euro duke u bazuar në përvojën e tij të punës që vërtetohet me Librezë të punës për katër paga të fundit të papaguara.

Kolegji i Apelit vëren po ashtu se paditësi me ankesën e tij në shkallën e parë dhe me parashtresën e tij të datës 03 korrik 2024, ka sjell provat vijuese, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 24 mars 2006, një listë të pagave të fundit të papaguara për muajt janar-mars 2006 nënshkruar nga drejtori i NSH-së, drejtori financiar dhe kryetari i sindikatës, me të cilën ai vërteton edhe lartësinë e pagës.

Bazuar në këto prova të cilat janë të mjaftueshme, Kolegji i Apelit konsideron se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke detyruar AKP-në që të paguaj shumën 1,442.28 euro, interesin ligjor prej 10% të borxhit kryesor në shumë prej 144.22 euro, si dhe shpenzimet e procedurës prej 124 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Edhe Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë se kjo kërkesë e paditësit nuk është parashkruar, ajo kërkesë buron dhe mbështet në Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Paditësi bazuar në udhëzimet e dhëna në këtë njoftim ai me kohë është paraqitë në procedurën e likuidimit, kërkesa e të cilit pa të drejtë ishte refuzuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumën prej 100 euro, me datën 09 gusht 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me 31 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
